



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep	DPK
Nr. Ifaq Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot Br. Prot Prot No	03-02/3855/18
Data Datum Date	06.11.2018



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2018 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Rregullores Nr.01/2014 dhe Rregullores Nr.01/2017 Të Punës Së Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë 06.11.2018, mori:

**V E N D I M**

**I.** *Mbyllt rasti me nr. AKK-03-02-2755/18, për zyrtarin e lartë z. Musa Dragusha, Anëtar i Bordit të Ankesave për Media, Komisioni i Pavarur i Mediave, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik.*

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

**I.** Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2755/18, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Musa Dragusha, Anëtar i Bordit të Ankesave për Media, Komisioni i Pavarur i Mediave, janë ndërmarr veprimet e parapara ligjore dhe është zhvilluar procedurat e paraparë për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit.



Ky rast ka filluar të trajtohet sipas detyrës zyrtare pas identifikimit dhe kontrollit procedural qe kanë bërë zyrtaret e AKK-së, për situatë të mundshme të konfliktit të interesit apo papajtueshmërive ne ushtrimin e funksionit publik.

Pas verifikimit të informacionit dhe të dhënave tjera të marra edhe nga institucionet kompetente është vërejtur se zyrtari i lartë z. Musa Dragusha, figuron si person i autorizuar në biznesin privatë me emër "Avokat Musa Dragusha", e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.06/L-011, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit duke përfshiri kufizim dhe papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër

Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese zyrtari i lartë z. Musa Dragusha, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtaret e AKK-së për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar.

Zyrtaret e Agjencisë Kundër Korrupsionit kanë pranuar kërkesën e zyrtarit z. Dragusha, dhe kanë organizuar në zyrat e AKK-së një takim me të, për ti prezantuar faktet qe posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar, duke e njoftuar se figuron si person si autorizuar në biznesin privatë me emër "Avokat Musa Dragusha" dhe i njëjti ushtron veprimtarin e Avokatit, e që sipas ligjit janë të ndaluara.

Në ketë takim zyrtari i lartë z. Musa Dragusha, pasi është informuar me faktet e prezantuara, ka theksuar se nuk ka qen në dijeni për kufizimet qe rrjedhin nga ligji por është zotuar se do të ndërmarr veprime sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke sjell dëshmi se nuk do të figuroj si person i autorizuar ne ketë biznes, dhe nuk do ta ushtroj veprimtarin e avokatit deri sa ushtron funksionin publik.

Pas këtyre veprimeve nga zyrtari i lartë z. Musa Dragusha, kemi pranuar informatën e lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë z. Musa Dragusha, nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesi me emër AVOKAT MUSA DRAGUSHA, si dhe kemi pranuar Njoftimin për pezullimin e ushtrimit të profesionit të avokatit (1231/18-29).

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Musa Dragusha, Anëtar i Bordit të Ankesave për Media, në Komisionin e Pavarur të Mediave, duke hequr dorë nga pozita si person i autorizuar ne biznesin privat dhe duke pezulluar ushtrimin e profesionit të avokatit, janë krijuar rrethana të reja dhe është shhangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë, dhe kufizimit ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,**

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havalli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

